

SUBJEKTI "TESLA" SH.P.K

TIRANË ME: 20.11.2019

DREJTUAR: AKM-TIRANE  
PER DIJENI: DRM-TIRANË  
BASHKISE TIRANË

"INDUSTRIË PRODHUESE TË KOMPONENTËVE  
ELEKTRIKE"  
ID 9.2 "PRODHIMI I PAJISJEVE ELEKTRIKE"

ID 9.2 "PRODHIMI I PAJISJEVE ELEKTRIKE"

SUBJEKTI "TESLA"

NIPTI L32318033B

ADRESA: TIRANE KASHAR KASHAR AUTOSTRADA TIRANE-  
DURRES, KM.5

TIRANË 2019

## SUBJEKTI "TESLA" SH.P.K

Zona në të cilën ndodhet ID 9.2 "PRODHIMI I PAJISJEVE ELEKTRIKE" është hapësirë e nevojshme për ushtrimin e këtij aktiviteti.

Duhet theksuar që subjekti ka disa kohe që e ushtron këto aktivitete në këto godina dhe nuk ka patur probleme me komunitetin dhe sipërmarresit e zonës.

Në të operojnë teknologjia dhe instalimet perkatese, ambientet e shërbimeve mbështetëse dhe parkimi.

Veprimtaria ushtrohet brenda një sipërfaqe të kufizuar dhe në një zonë pa vlera të vecanta pejsazhere

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë nuk ka emetime pluhurash por vetëm emetime zhurmash. Këto emetime janë të kufizuara në kohë dhe hapësirë.

I gjithë procesi i teknologjik është i thatë, pra nuk ka nevojë për dorimin e ujit teknologjik.

Gjatë punës nuk ka asnjë shkarkim në ajër dhe asnjë shkarkim në ujë.

### **Ndikimet në mjedis**

Ky aktivitet nuk pritet të ketë ndikim mjedisor të matshëm pasi:

- Ushtrimi i këtij aktiviteti nuk do të ndikojë në ndryshimin e nivelit të ujërave tokësore, në rrugët ujore dhe në nivelin hidrostatik të ujërave nëntokësore, pasi në këtë zonë ku ndodhet objekti dhe përreth tij nuk ka burime ujore nëntokësore dhe shpime të ndryshme hidrogeologjike që do të mund të dëmtoheshin nga ky aktivitet.
- Nuk shkakton ndotje të tokës me shkarkime të ndryshme të lëngëta apo të ngurta.
- Ushtrimi i këtij aktiviteti nuk do të ndikojë në cilësinë e ajrit të zonës, pasi nuk do të ketë shkarkime në ajër të gazrave, pluhurave apo tymrave.
- Gjatë ushtrimit të këtij aktiviteti nuk do të ketë emetime të ndryshme kimike të llojeve të ndryshme.
- Nuk parashikohen dëmtime të florës dhe faunës së zonës.
- Zhurmat në mjediset e punës janë brenda normës sanitare të lejuar, dhe për pasojë as zhurmat në mjediset e jashtme nuk pritet të kenë ndikim në popullatën përreth.

Niveli i zhurmës nuk i kalon 55-70 dB(A) gjatë punës. Ky nivel zhurmash është brenda normave dhe nuk ndikon në shëndetin e punonjësve.

- Ka vlera normale të temperaturës dhe të lagështisë në mjediset e punës
- Janë marrë të gjitha masat për mbrojtjen në punë nga aksidentet dhe për evitimin e rrezikut nga zjarri.
- Fenomene të tjera. Vibracioni, nxehtësia, radiacioni, ndriçimi verbues etj. nuk janë të pranishme.

## Konkluzione

Subjekti "TESLA" ka mjetet e nevojshme teknike dhe financiare për të zhvilluar këtë aktivitet dhe kërkon të jetë e pajisur me të gjitha lejet përkatëse sipas legjislacionit shqipëtar.

Aktiviteti konsiderohet i përshtatshëm dhe i pranueshëm në zonën e zgjedhur nga investitori, pa krijuar probleme mjedisore për zonën përreth.

Aktiviteti nuk gjendet ne Shtojcen per proceduren e VNM paraprake ose te thelluar te Ligjit Nr 10 440 për Vlerësimin e Ndikimit Në Mjedis, datë 7.7. 2011. Ne Perputhje me VKM nr. 419 date 25.06.2014 Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respective të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja , ky subject duhet te aplikojte per leje mjedisi të tipit B ne AKM-Tirane. Adresa e AKM-se, ku publiku mund te dergoje komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo ne forme Elektronike:

Adresa: Rruga "Sami Frasheri" Nr.4, Tirane, - Tel/Fax 04 2 371 237 [www.akm.gov.al](http://www.akm.gov.al)

Konform te te gjitha akteve dhe procedurave ligjore ne fuqi i drejtohem AKM-Tirane per ndjeken e procedures konsultimit me publikun dhe palet e interesuara per aplikimin per LEJE MJEDISI TE TIPIT B.

ADMINISTRATOR

Z. IDLIR LALO